




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E MBROJTJES



12-18 JANAR

JAVA E MBROJTJES



RRITEN FONDET PËR MBROJTJEN CIVILE

Qeveria shqiptare, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes ka rritur mëshitetjen financiare për mbrotjen civile. Në zbatim të ligjit “Për buxhetin e vitit 2026”, janë parashikuar: 1 mld lekë në formën e transfertës së kushtëzuar, e cila ndahet në 500 mln lekë për investime si dhe 500 mln lekë për kompensimin e qytetarëve të prekur në raste zjarresh apo përmbytjesh. 1,5 mld lekë janë parashikuar për financimin e projekteve që lidhen me parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe 300 mln lekë për financimin e projekteve për digat dhe rezervuarët.

★★★★★

REHABILITOHEN URAT E DËMTUARA NGA RESHJET

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, ka diskutuar me drejtues të pushtetit vendor dhe strukturave përgjegjëse për emergjencat mbi rehabilitimin e urave të dëmtuara dhe garantimin e sigurisë për komunitetet pas situatës së krijuar nga përmbytjet. Ai vlerësoi reagimin e shpejtë të Repartit të Xhenios, i cili në kohë rekord po ndërhyrë në të gjitha urat ku ka pasur dëmtime si pasojë e reshjeve të dendura për disa ditë me radhë.

★★★★★

FORCAT E ARMATOSURA NË GATISHHMËRI

Gjatë kësaj jave, Forcat e Armatosura dhe Emergjencat Civile kanë qenë në gatishmëri të plotë, duke u ardhur në ndihmë banorëve të prekur nga përmbytjet. Efektivët e repartit Xhenio kanë punuar për përmirësimin dhe rikuperimin e infrastrukturës së dëmtuar, ndërsa i gjithë zinxhiri i Emergjencave Civile mbetet në gatishmëri për t'iu përgjigjur çdo shtate.

★★★★★



MINISTRI VENQU INSPEKTIM NË MENGËL

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, i shoqëruar nga kryetari i Bashkisë së Elbasanit Gledian Llatja inspektoi mjediset e njësisë së Batalionit të Emergjencave Civile në Mengël të Elbasanit, një nga bazat me përdorim të dyfishtë, që po forcohen si pjesë e rrjetit kombëtar të sigurisë dhe reagimit ndaj fatkeqësive natyrore. Gjatë inspektimit, ministri Vengu theksoi se Mengëli është pjesë integrale e rrjetit të bazave që synohet të bëhen gjithnjë e më funksionale, me kapacitete të shtuara njerëzore dhe logjistike.

★★★★★



GRADIMI I OFICERËVE

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përmbyllën me sukses procesin e konkurrimit dhe gradimit, në kuadër të të cilit u promovuan 15 oficerë të Forcave të Armatosura. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu e cilësoi ceremoninë e gradimit një ditë të veçantë, ndërsa vlerësoi përkushtimin e tyre, profesionalizmin dhe punën e palodhur të ushtarakëve, të cilët me integritet, viligjencë, disiplinë dhe përgjegjësi i shërbejnë atdheut dhe sigurisë kombëtare, përballë çdo sfide të përditshme. ★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

VIJON ME SUKSES MISSIONI NË NOVO SELO

Kontigjenti VI i Forcës Tokësore shqiptare ka përmbyllur me sukses misionin në Novo Selo të Bullgarisë, duke përfaqësuar vendin me profesionalizëm dhe sipas standardeve të NATO-s. Ndërkohë, Kontigjenti VII ka marrë zyrtarisht detyrën, gati për të vijuar angazhimin e Shqipërisë në sigurinë kolektive krah aleatëve.





PËRFUNDON STËRVITJA “ÇAKALLA 01-2026”

Kursi i 64-të Bazë i Nënoficerit përfundoi me sukses stërvitjen 24-orëshe “ÇAKALLA 01-2026”, ku 59 kursantë u testuan në kushte reale fushore. Gjatë dy muajve trajnim intensiv, ata dëshmuan disiplinë, bashkëpunim dhe gatishmëri të lartë operacionale.

JM



mod.gov.al

MINISTRI VENGU TAKIM ME ATASHETË

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, zhvilloi një takim me atashetë dhe përfaqësuesit ushtarakë shqiptarë, ku u theksua roli i diplomacisë ushtarake në forcimin e pozicionit të Shqipërisë në NATO dhe në rritjen e sigurisë rajonale e euroatlantike. Gjatë takimit u nënvizua se Shqipëria mbetet një aleat i besueshëm dhe i përkushtuar në përmbushjen e angazhimeve të saj.

★★★★★